



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:207994
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05738573

AC.nr.1148/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Besnik Bislimaj, antarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.R., nga P., rruga xxx të cilin e përfaqëson me autorizim B.A., avokat në P., rruga xxxx kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “K.e R”, me seli në P., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit N. B., nga P., me bazë juridike Kompensim dëmi, me vlerë të kontestit 4,100 Euro, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga e paditura, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm C.nr. 1942/15, të datës 11.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **20.05.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “K. e R” me seli në P., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër C.nr.1942/15, dt: 11.11.2020, në pikën **I** dhe **III** të dispozitivit të tij **VËRTETOHET**.

II.Pika II e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër C.nr.1942/15, dt: 11.11.2020, **ngel e pa shqyrtuar**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm me aktgjykimin C.nr. 1924/15, të datës 11.11.2020, ka vendosur si në vijim:

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit A. R., nga P., DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "K. e R", me seli në P., që paditësit në emër të kompensimit të dëmit, për aksidentin e datës 16.04.2015, t’ia paguaj shumat e specifikuar si më poshtë:

Dëmi jo material:

- kompensim, në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, shumën prej:..... 1,000 Euro.
- kompensim, në emër të frikës së përjetuar, shumën prej:..... 700 Euro.

Dëmi material:

- kompensim, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, shumën prej:..... 90 Euro.
- kompensim, në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej:..... 90 Euro.

II. REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë së paditësit dhe atë në emër të kompensimit për dhimbjet e përjetuara fizike, në shumë prej 2,550 Euro, në emër të kompensimit për friken e përjetuar, në shumë prej 1,785 Euro, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, në shumë prej 288 Euro, në emër të ushqimit të përforcuar, në shumë prej 288 Euro dhe në emër të rehabilitimit klimatik, në shumë prej 315 Euro, SI E PA BAZUAR.

III. DETYROHET e paditura që paditësit, shumat e gjykuara sikurse në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data 11.11.2020 (data e marrjes së aktgjykimit), e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 714.40 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të përcaktuar ligjor, ankesë ka ushtruar e paditura KS “K, e R” me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe duke marrë parasysh interesin juridik të parashtruesit të ankesës, konsiderohet se e njëjta aktgjykimin e ankimuar e ka atakuar vetëm pjesërisht dhe atë në pikën I, dhe III të dispozitivit të tij, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar dhe të prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën ta kthej në ri vendosje.

Paditësi, brenda afatit ligjor ka ushtruar përgjigje në ankesën e të paditurës, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës, me propozim që ankesa të refuzohet e pa bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, si gjykatë ankimore, pas shqyrtimit të ankesës, pretendimeve ankimore, vlerësimit dhe analizimit të provave në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d) në lidhje me nenin 200 të LPK-së, konstatoi se:

Ankesat e të paditurës KS “K.e R” me seli në Prishtinë, rezulton e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, A.R. nga P me datën 18.07.2015, përmes të autorizuarit të tij, avokat B. A. nga P. ka ushtruar padi për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga autopërgjegjësia kundër të paditurës Ks “K. e R” me seli në P., dhe me precizimin e padisë, ka kërkuar që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit i datës 16.04.2015, t'ia paguajë paditësit shumën totale prej 4,811 euro, me kamatë ligjore prej 8% vjetore si dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura në përgjigje në padi dhe në seancat gjyqësore ka deklaruar se e kontestoj kërkesëpadinë e paditësit për lartësinë e dëmit material dhe jomaterial, me arsyetim se shumtat e kërkuara janë paushalle dhe të pabazuara në kriteret e BQK-së, ndërsa gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë dhe ka propozuar që kontesti të mbyllet me marrëveshje gjyqësore, duke i ofruar paditësit shumën prej 800 Euro, për të gjitha kategoritë e kompensimit të dëmit material dhe jo material, duke kërkuar nga gjykata që shumtat e precizuara mbi shumën e ofruar ta refuzon si të pabazuara, duke e kontestuar edhe kamatën e kërkuar sipas precizimit të kërkesëpadisë për arsye se është kërkuar nga data 17.08.2015, ndërsa kamata për dëmet materiale duhet të gjykohet nga dita e aktgjykimit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas nxjerrjes dhe administrimit të provave, mbajtjes së seancave gjyqësore, ka nxjerr aktgjykimin e ankimuar me vendosje më të hollësishme si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë ka theksuar se me provat e administruara gjykata ka gjetur se me datë 16.04.2015, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit në rrugën Kishnapole-Vrellë, deri të aksidenti i trafikut ka ardhur derisa paditësi ishte duke udhëtuar me automjetin e tipit “Daimler”, me targa të regjistrimit xxxx, ku papritmas automjeti i tipit “Daimler”, me targa të regjistrimit xxx, të cilin e drejtonte B. K., i cili duke mos përshtatur shpejtësinë kushteve të rrugës e humb kontrollin mbi automjet dhe kalon në shiritin e kundërt të lëvizjes dhe me këtë e kishte goditur paditësin duke i shkaktuar lëndime trupore. Deri të kjo gjendje faktike gjykata ka ardhur duke u mbështetur në këto prova të cilat i ka pranuar si të besueshme dhe atë: Raportin e policor me nr. 2015-CR-82, të datës 16.04.2015 dhe skica e vendit të aksidentit.

Fakti se i siguruari të e paditura është shkaktar i aksidentit nuk ka qenë rrethanë kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse, pra e paditura e ka pranuar bazën juridike të kërkesëpadisë, prandaj gjykata gjen se baza juridike që e paditura të jetë përgjegjëse për ta kompensuar paditësin gjene mbështetje në dispozitat nga neni 136, 137, 140 dhe 159 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë gjykata sipas propozimit të palëve në cilësinë e provës materiale ka nxjerr ekspertizën mjekoligjore të punuar nga Dr. Milazim Haxholli, Ortoped - Traumatolog dhe Dr. Samire Braina, Psikiatër, të cilët kanë dhënë mendimin profesional, përmes ekspertizës me shkrim të punuar me datë 05.10.2020, me ç’rast janë deklaruar për natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi si pasojë e aksidentit.

Ekspertët Dr. Milazim Haxholli dhe Dr. Samire Braina, pas ekzaminimeve përkatëse kanë ardhur në përfundim se paditësi si pasojë e aksidentit ka pësuar ndrydhje të indeve të buta të qafës, ndrydhje të shpinës, ndrydhje të gjoksit të shkaktuara nga rënja, goditja më mjetë të fortë, si pasojë e aksidentit në trafik dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore. Kanë konstatuar se paditësi për shkak të lëndimeve të pësura ka përjetuar dhimbje fizike me intensitet të rëndë në kohëzgjatje prej 1 ditë, me intensitet të mesëm me kohëzgjatje prej 18 ditë, kurse me intensitet të ulët ende vazhdon sipas ekzaminimit të drejtëpërdrejtë.

Frika primare në momentin e aksidentit ka zgjatë disa sekonda, që është përcjell me frik nga vdekja dhe kërcënimit serioz për integritetin e tij trupor, frikë sekondare me intensitet të lartë ka zgjatur 48 orë, e manifestuar me frikë nga invaliditeti, çrregullime të gjumit, rikujtime të shpeshta të ngjarjes, frikë sekondare me intensitet mesatar dhe më të ulët ka zgjatë për 2 deri 4 muaj dhe është ende e pranishme e manifestuar me reagime emocionale të karakterit anksioz, lodhje në angazhimet minimale, frikë dhe pasiguri ka edhe sot e kësaj dite në pjesëmarrje në komunikacion, por të intensitetit të ulët.

Shëmtim trupor nuk ka, zvogëlim të aktivitetit jetësor nuk ka, përkujdesja e personit të tretë ka qenë e nevojshme për 18 ditë, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 18 ditë dhe rehabilitimi fiziatriko – psikik 15 ditë.

Gjykata e ka pranuar ekspertizën mjekësore në tërësi si të besueshme, meqë e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë.

Për lartësinë e kërkesëpadisë dhe për kategoritë e caktuara të dëmit jo material, Gjykata vendosi në kuptim të nenit 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve (LMD-së). Me këtë rast gjykata pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i gjykuar gjithmonë duke pasur parasysh që kompensim të jetë satisfakcion për të dëmtuarin, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësit.

Gjykata pasi konstatoi rrethanat e rastit duke pasur parasysh dhimbjet e pësuar fizike, e sidomos intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, e duke marrë për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit sidomos moshën e të dëmtuarit, praktikën gjyqësore, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar. Gjykata pati në konsideratë të veçantë me rastin e vendosjes dhimbjet e pësuar fizike, e sidomos intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës si dhe kohëzgjatjen e tyre sipas ekspertizës, prandaj sipas një vlerësimi të harmonizuar të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e kompensimit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërkaq, sa i përket dëmit material të krijuar për përkujdesjen e personit të tretë dhe ushqimit të përforcuar, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke marr parasysh faktin se për këto forma të dëmit palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjaret e tyre dhe ushqimi i përforcuar, i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Mirëpo, pasi që paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e huaj dhe ushqim të përforcuar (të konstatuar në ekspertizë), të njëjtit ligjërisht i takon ky lloj dëmi i kërkuar në shumat e gjykuara.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me dëmin jo material gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që vlerësoi se kompensim përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë, ndërsa në pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me dëmit material gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që nga ana e palës paditëse gjykatës nuk i'u ofruan prova me të cilat vërtetohet dëmi. Paditësi nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilën do ta vërtetonte lartësinë e kërkesës së pretenduar për dëmin material që i referohet kompensimit për rehabilitim klimatik. Andaj në

mungesë të dëshmive për dëmin material gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë, bazuar në nenin 319 par. 1 të LPK-së.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 par. 1 dhe 2 të LMD-ës, ku është paraparë se Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit.

Ndërsa si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës gjykata ka caktuar datën e marrjes së aktgjykimit.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit për padi 104 Euro, për dy seanca të mbajtura secila nga 135.20 Euro, shpenzimet për ekspertizë mjekësore 300 Euro dhe për taksë gjyqësore për padi 40 Euro, (sipas tarifës së Odës së Avokatëve).

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar në pikën I dhe III të dispozitivit me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, dhe as shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par.2, pika n) të pretenduara nga pala ankuese, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht dhe se drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur se gjykata e shkallës së parë me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit të ankimuar ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika n), ngase nga nga përmbajtja dhe struktura e aktgjykimit të ankimuar, konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka harmonizuar në tërësi përmbajtjen si në pikën I dhe III të dispozitivit dhe se e njëjta ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare të cilat kanë rezultuar me aprovimin e kërkesëpadisë si në pikat e atakuara me ankesë, prandaj, ky pretendim ankimor rezulton i pa bazuar.

Meqë, ndërmjet palëve ndërgjyqëse baza juridike e kërkesëpadisë nuk ishte kontestuese, dhe ankesa me pretendimet ankimore i referohet vetëm kontestimit të të njëjtës sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, atëherë, gjykata e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të të njëjtave vlerëson se edhe pretendimet ankimore të të paditurës lidhur me lartësinë e kompensimit të gjykuar si për dëmin material ashtu edhe jo material si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, ngase nga shkresat e lëndës ashtu siç edhe është vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë, përderisa baza juridike mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese nga konstatimet e ekspertëve mjekësor është vërtetuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka pësuar ndrydhje të indeve të buta të qafës, ndrydhje të shpinës, ndrydhje të gjoksit të shkaktuara nga rënja, goditja më mjetë të fortë, si pasojë e aksidentit në trafik dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore. Kanë konstatuar se paditësi për shkak të lëndimeve të pësuar ka përjetuar dhimbje fizike me intensitet të rëndë në kohëzgjatje prej 1 ditë,

me intensitet të mesëm me kohëzgjatje prej 18 ditë, kurse me intensitet të ulët ende vazhdon sipas ekzaminimit të drejtëpërdrejtë.

Frika primare në momentin e aksidentit ka zgjatë disa sekonda, që është përcjell me frikë nga vdekja dhe kërcënimit serioz për integritetin e tij trupor, frikë sekondare me intensitet të lartë ka zgjatur 48 orë, e manifestuar me frikë nga invaliditeti, çrregullime të gjumit, rikujtime të shpeshta të ngjarjes, frikë sekondare me intensitet mesatar dhe më të ulët ka zgjatë për 2 deri 4 muaj dhe është ende e pranishme e manifestuar me reagime emocionale të karakterit anksioz, lodhje në angazhimet minimale, frikë dhe pasiguri ka edhe sot e kësaj dite në pjesëmarrje në komunikacion, por të intensitetit të ulët.

Shëmtim trupor nuk ka, zvogëlim të aktivitetit jetësor nuk ka, përkujdesja e personit të tretë ka qenë e nevojshme për 18 ditë, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 18 ditë dhe rehabilitimi fiziatriko – psikik 15 ditë, drejtë dhe plotësisht si dhe në proporcion me këto pasoja, është gjykuar edhe shuma e kompensimit si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e gjendjes së vërtetuar faktike, drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë përderisa baza juridike e të njëjtës nuk ishte kontestuese mes palëve, i është referuar nenit 136 par.1 në lidhje me nenin 137 e në lidhje me nenin 159 par.1 në lidhje me nenin 918 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, sa i përket lartësisë së dëmit material dhe jo material të gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, e njëjta drejtë ka zbatuar nenin 169, par.1 dhe 3, në lidhje me nenin 173 par.1 në lidhje me nenin 179 dhe 183 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve ku përcaktohet e drejta e të dëmtuarit që në rastet e pamundësisë së kthimit në gjendje të mëparshme për dëmin material, shpërblymi të njëjtit ti ipet në të holla, ndërsa për faktin se të njëjtit i janë shkaktuar edhe shpenzime të shërimit të faktuara me prova përkatëse dhe për dhimbjet fizike dhe frikën e pësuar si pasojë e aksidentit në kuptim të nenit 183 të këtij ligji, dhe në harmoni të plotë edhe me Udhëzuesin Juridik të Miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës nr. 41/23, dt: 27.02.2023, për kriteret orientuese të zbatuara në caktimin e lartësisë së kompensimit të dëmit material dhe jo material, dhe se gjykata e shkallës së parë, duke marrë për bazë të mirat e cenuara në rastin konkret e të konstatuara edhe nga ekspertët mjekësor drejtë dhe në proporcion ka caktuar kompensimin e dëmit material dhe jo material si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa sa i përket shpenzimeve të shërimit, të njëjtat janë vërtetuar edhe me fatura përkatëse nga ana e paditësit, e të cilat shpenzime drejtë dhe në mënyre të saktë i janë njohur paditësve.

Gjithashtu, sa i përket kamatëvonesës, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, ku i është referuar nenit 382 par.1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, si dhe momentit të përcaktimit të rrjedhjes së saj, dhe kjo vendosje pranohet edhe nga gjykata e shkallës së dytë, ngase është në përputhje edhe me Mendimin Juridik për Kamatën të miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës nr. 265/20, dt: 01.12.2020, gjegjësisht pikën II, V dhe XIV të këtij mendimi, ku përcaktohet ligji i aplikueshëm, shkalla e kamatëvonesës dhe periudha e rrjedhjes së saj dhe vendosja nga gjykata e shkallës së parë është në përputhje me këto pika, ka gjykuar shkallën e kamatëvonesës prej 8% vjetore nga data e nxjerrjes së aktgjykimit, e të cilën vendosje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata ka vendosur në mënyrë të duhur sepse i ka arsyetuar shpenzimet e gjykuara për secilin veprim të ndërmarrë në procedurën kontestimore, e të cilat veprime edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit kanë qenë të domosdoshme në mënyrë që gjykata të vendosë për themelësinë e kërkesëpadisë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. Lartësia është në përputhje me tarifën për përfaqësim dhe po ashtu në përputhje me tarifën për taksa gjyqësore dhe ekspertiza. Palët e paditura janë të obliguara për pagesën e shpenzimeve procedurale bazuar në dispozitën ligjore të nenit 452 paragrafi 2 të LPK së ku parashihet se “*Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve*”, në lidhje me nenin 459, par. 2 të LPK-së, ku përcaktohet se “*. Po që se ekzistojnë dallime të rëndësishme në pikëpamje të pjesëve që u takojnë në objektin e kontestit, gjykata do të caktojë, sipas përpjesëtimit të pjesëve të tilla, sa do të jetë pjesa e shpenzimeve të cilën do ta shpërblej secili bashkëndërgjyqës veç e veç*”, dhe duke marrë për rezultatit e pjesërishtëm nga kërkesëpadia e paditësit, del se drejtë është vendosur edhe për shpenzimet e procedurës, si në pikën III të dispozitivit të tij.

Meqë, aktgjykimi i ankimuar duke pasë për bazë interesin juridik të parashtruesit të ankesës nuk është atakuar në pikën II të dispozitivit të tij (pjesën refuzuese të kërkesëpadisë), duke marrë për bazë edhe institutin “*Reformatio in Peius*” nga neni 203 i LPK-së, atëherë gjykata e shkallës së dytë, këto pika të aktgjykimit të ankimuar nuk i shqyrtoi fare.

Nga sa u tha më lartë, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 195 paragrafi 1 pika (d) dhe nenin 200 e LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr. 1148/21, data 20.05.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka